



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 48
Prishtinë, 27 tetor 2009, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Teuta Hadri, Fatmire Berisha, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina, Flora Brovina dhe Nurishahe Hulaj.

Munguan: Rita Hajzeraj, Gjylnaze Syla, Sllobodan Petroviq dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore, nga NDI- ja, Shefki Kastrati, nga OSBE - ja, Lejla Selimi dhe nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i shkresës së mjekëve specialistë të biokimisë klinike;**
- 4. Shqyrtimi i shkresës së Stafit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale**
- 5. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të QKUK – s,**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Deputetja Fatmire Berisha propozoi të hiqet nga procesverbali i mbledhjes së kaluar konstatimi që në mbledhjen e radhës të ftohen ministri i Ministrisë së Punës dhe i Mirëqenies Sociale dhe përfaqësuesit e sindikatave, pasi që ky takim nuk u realizua, sepse në të njëjtën ditë është mbajtur seanca plenare, në të cilën ishte i radhitur për shqyrtim edhe Ligji për sindikatat.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me propozimin e deputetes Fatmire Berisha.

3. Shqyrtimi i shkresës së mjekëve specialistë të biokimisë klinike;

Sadik Idriz – Komisioni ka shqyrtuar edhe më parë këtë shkresë, por nuk u nxor asnjë rekomandim. Biokimistët nga Komisioni kanë kërkuar përsëri përgjigje.

Mimoza Ahmetaj – Propozoi të analizohen planprogrami dhe përgatitja e këtyre biologëve laborantë ose të kërkohet nga Rektorati të sqarojë se kur është hapur ky drejtim, a është menduar se çka do të punonin këta të diplomuar. Nuk jam që këta të mbeten pa punë, por edhe nuk jam dakord që këta të hapin laboratorë pa përgatitjen e duhur.

Teuta Hadri – Tha se Qeveria, Ministria e Shëndetësisë dhe Rektorati duhet ta zgjidhin këtë problem. Komisioni nuk mund të merret me një vendim që e ka nxjerrë Qeveria. Mendoj që institucionet kompetente të merren me këtë problematikë.

Nurishahe Hulaj – Komisioni e dëgjoi mendimin e biokimistëve. Kemi edhe vendimin e Qeverisë që studentëve që i kanë përfunduar studimet në biologjinë aplikative t'u mundësohet njësoj, si në vendet e tjera, të punojnë në laboratorë si bashkëpunëtorë shëndetësorë, në laboratorë eksperimentalë, në laboratorë veterinarie, në Agjencinë për ushqimin, por të mos kenë të drejtë vule dhe të drejtë licence. Duhet të gjendet një zgjidhje, pra të japim një rekomandim se ku mund të punësohen këta të diplomuar.

Qamile Morina – Ne, si ligjvënës, duhet të jemi më kompetentët ta mbrojmë ligjin. Nga vendimi i kryeministrit shihet se ky vendim është në kundërshtim me ligjin. Shteti duhet të funksionojë me ligje dhe këtu duhet të ceket se a është respektuar ligji. Ky është vendim pa bazë ligjore dhe ne duhet të insistojmë të respektohet ligjshmëria. Përgatitja e këtyre të diplomuarve në biologjinë aplikative nuk është ekuivalente me përgatitjen e biokimistëve, prandaj nuk duhet të bëhet arbitraritet dhe të barazohen. Duhet të kërkojmë nga institucionet, që e kanë hapur këtë drejtim, a është menduar ku do të punojnë këta të diplomuar.

Mimoza Ahmetaj – Më parë është hapur ky drejtim pa u analizuar mirë, tani kryeministri është dashur të gjente zgjidhje për këta të diplomuar, për të mos i lënë në rrugë. Pajtohem me propozimin se këta të diplomuar në biologjinë aplikative të kenë të drejtë të punojnë në laboratorë, por mendoj se tendenca e tyre është që këta të hapin vetë laboratorë, që të jenë të barabartë me biokimistë.

Sadik Idriz – Në vendim të Qeverisë është edhe paragrafi ku thuhet që „ Pas përfundimit të lëndëve mjekësore(kandidatët për laborantë të lartë mjekësorë) dhe stazhit prej 6 muajsh, krijohen kushtet që ata të mund të parashetrojnë kërkesën për ta dhënë provimin profesional dhe t’i nënshtrohen provimit final të licencës, sikur të gjithë punëtorët e tjerë shëndetësorë. Në pasuesin tjetër thuhet „ Kandidatët e licencuar i gëzojnë edhe të drejtat e tjera të parapara në bazë të Ligjit të shëndetësisë. Një gabim që është bërë më parë nuk përmirësohet, por bëhet edhe një tjetër gabim dhe mendoj se kjo nuk është në rregull. Komisioni ynë nuk mund të marrë ndonjë vendim, por mund të nxjerrim vetëm rekomandime, që biologët aplikativë të jenë vetëm bashkëpunëtorë shëndetësorë.

Qamile Morina – Propozoi të kërkohet nga Fakulteti i Biologjisë se mbi cilat baza e ka hapur biologjinë aplikative, të njoftohemi për programin mësimor të këtyre studentëve.

Pas diskutimeve u propozua që një grup i deputetëve të Komisionit në përbërje Sadik Idriz, Mimoza Ahmetaj dhe Nurishahe Hulaj t’i ftojë dekanin e Fakultetit të Mjekësisë dhe dekanin e Fakultetit të Biologjisë dhe të diskutohet për nxjerrjen e disa rekomandimeve për Komisionin lidhur me këtë çështje.

4. Shqyrtimi i shkresës së Stafit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale

Sadik Idriz – Kjo është një shkresë e Stafit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale, që institucioneve të Kosovës ua paraqesin disa kërkesa. Në këtë shkresë ata kërkojnë që duke u bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, të merret vendim që AKPM- ja të jetë e pavarur nga MSH- ja dhe të raportojë në Kuvendin e Kosovës.

Kërkesë tjetër është që menjëherë të zhbllkohet Projektligji për AKPM- në, që të bëhet rishikimi i buxhetit për vitin 2010, të implimentohet vendimi nr. 07/29 i kryeministrit për kuadro deficitarë, si dhe të implimentohet menjëherë vendimi për specializimin e kuadrove të AKPM- së. Hap diskutimin.

Mimoza Ahmetaj – Stafi i AKPM-së ka parashtruar disa kërkesa. Sa i përket kërkesës së parë mendoj se është një standard evropian, por edhe në Amerikë agjencitë medicinale janë të ndara nga Ministria e Shëndetësisë. Edhe neni 142 i Kushtetutës parashih që agjencitë të jenë të pavarura dhe t’i raportojnë Kuvendit, por edhe t’i zbatojnë politikat e Qeverisë. Ligji për AKPM- në është në procedurë miratimi. Kërkesat e tjera kanë të bëjnë edhe me institucionet e tjera. Propozoj t’i ftojme përfaqësuesit e Stafit të AKPM-s që më për së afërmi të njoftohemi për kërkesat e tyre.

Nurishahe Hulaj – Sipas dokumentacionit që kemi AKPM - ja është themeluar me një rregullore të UNMIK ut. Tani pasi e kemi Kushtetutën duhet ta kemi edhe Ligjin e të mos rregullohet AKPM - ja me rregullore. Neni 142 i Kushtetutës është shumë i qartë, prandaj i përkrahi kërkesat e Stafit të AKPM- s, si shumë të drejta.

Qamile Morina – Në vendet e rajonit Agjencia për Produkte Medicinale është e pavarur, por është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Ne duhet të përshtatemi edhe me vendet në rajon. Kjo Agjenci edhe tani në shumë çështje është shumë e pavarur. Duhet të qartësohet se cilat janë kompetencat e MSH- s dhe cilat janë kompetencat e AKPM- s.

Flora Brovina – E përkrahi propozimin që të ftohet Stafi i AKPM - s dhe pastaj Komisioni të nxjerrë rekomandim që t’ia drejtojë Kuvendit.

Sadik Idriz – Propozoj të ftohen sekretari i MSH - s dhe përfaqësuesit e Stafit të AKPM –s. Pasi të merren informatat e nevojshme Komisioni të nxjerrë rekomandim për këtë kërkesë.

Pas diskutimit Komisioni u pajtua që të ftohen Sekretari i MSH- s dhe përfaqësuesit e stafit të AKPM- s, që të diskutohet për kërkesat e parashtruara nga Stafi i AKPM- s.

5. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të QKUK – s

Sadik Idriz - Tha se edhe kjo shkresë u është drejtuar disa institucioneve, por mendoj se ky komision nuk ka kompetencë ta shqyrtojë çështjen e parashtruar për zgjedhjen e drejtorit të QKUK - s. Kjo është në kompetencë të ekzekutivit. Hap diskutimin.

Flora Brovina – Pajtohet se kjo çështje nuk është kompetencë e Komisionit.

Mimoza Ahmetaj – Ky është paralajmërimi i dytë nga sindikalistët që na drejtohen. Nëse nuk ndërmerret diçka për tejkalimin e kësaj gjendjeje, atëherë ata do të jenë më radikalë. Nuk do të ishte mirë të ndodhë kjo. Pasi gjendja është shumë e ndërlikuar, pajtohem që zgjedhja e drejtorit të QKUK- s të shtyhet derisa të formohet bordi. Ne s’ e kemi të drejtën e vendimmarrjes, por e kemi të drejtën të pajtohemi ose të mos pajtohemi me kërkesat e parashtruara.

Sadik Idriz – Komisioni ynë nuk është pjesë e Komisionit për zgjedhjen e drejtorit të QKUK- s dhe nuk kemi kompetencë të ndërhyjmë në këtë çështje. QKUK - ja e ka statusin e vet, ku përcaktohet edhe mënyra e zgjedhjes së drejtorit.

Qamile Morina – QKUK-ja e ka statusin, por çështja është shumë e rëndë. Ky komision duhet ta bëjë një deklaratë për media dhe të kërkohet urgjentisht nga Qeveria dhe nga MSH- ja të formojnë komision dhe sa më parë të zgjidhet drejtori i QKUK- s. Ky është obligim i Komisionit tonë.

Pas diskutimeve të shkresës së Sindikatës së QKUK- s, Komisioni e përkrahi kërkesën e përshpejtimit të procedurës për zgjedhjen e drejtorit të QKUK-s, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në këtë institucion të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 20

E hartoi
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz